




Të reja ▾ Kush jemi ▾ Historiku Shërbime ▾ Baza ligjore Vendndodhjet Video Programi i transparencës ▾ Kontakt

Denonco Krimin Kibernetik Drejtoritë Vendore ▾ Policia Kufitare ▾ Policia Rrugore ▾ Donacione Policimi në Komunitet

Përmbledhja Mujore Për sinjalizimin Të Guximshëm pa Armë

Breaking News:

Rezultatet kryesore të strukturave policore në vend dhe ngjarjet e ndodhura gjatë 24 orëve të fundit



Lajmet Operacionet

10/06/2026

DVP Durrës/Finalizohet Operacioni I Koduar "Kalibri"

DVP Durrës/Finalizohet operacioni i koduar "Kalibri". Goditen 2 raste të tjera të mbajtjes pa leje, të armëve të zjarrit.

Sekuestrohen 2 armë zjarri, 1 granatë, 3 krehra armësh, qindra fishekë luftarak dhe sasi Cannabis.

Vihen në pranga 3 shtetas.

Si rezultat i intensifikimit të kontrolleve dhe punës operative, me objektiv identifikimin dhe ndalimin e shtetasve që përbëjnë rrezik për sigurinë publike, duke poseduar ose shitur armë zjarri, me qëllim kryerjen e ngjarjeve kriminale, Seksioni për Hetimin e Narkotikëve dhe Komisarati i Policisë Shijak, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale, finalizuan operacionin e koduar "Kalibri".

Gjatë operacionit u arrestuan shtetasit:

-L. D., dhe A. M., të dy banues në Lezhë, të cilët u kapën duke lëvizur me automjet, në hyrje të qytetit të Durrësit, dyshohet për të shitur një armë zjarri (pistoletë) me 2 krehra dhe fishekë. Arma dhe municioni u gjetën në çantën e pasagjerit, shtetasit L. D., të cilit iu gjet dhe një sasi e vogël lënde e dyshuar narkotike Cannabis Sativa;

-D. T., pasi gjatë kontrolleve në banesë në fshatin Shtrazë, Shijak, iu gjetën 1 armë zjarri (kallashnikov), 1 granatë mbrojtëse (me ndezës të montuar), 1 krehër arme dhe qindra fishekë luftarak, që posedoheshin pa leje.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.



DVP Durrës/Finalizohet operacioni i koduar "Kalibri"

Policia e Shtetit

DVP DURRËS

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Rezultatet kryesore të strukturave policore në vend dhe ngjarjet e ndodhura gjatë 24 orëve të fundit

Dibër/Finalizohet operacioni policor i koduar "Dërgesa" ▶